




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.506/2023

Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.25, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 33 dhe 34 i Rregullores Nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në takimin 317-të, të mbajtur më datë 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Rrezarta Lleshaj, gjyqtare me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve më datë 13 nëntor 2023, i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të vendos mbi propozimin për riemërimin e gjyqtarës Rrezarta Lleshaj, me mandat të përhershëm, mandati fillestar i të cilës përfundon më 18 janar 2024.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 27 nëntor 2023, pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, vendosi që gjyqtarja Rrezarta Lleshaj, të propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Znj. Rrezarta Lleshaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë;
- Kryetares të Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.